



Tregu / Këndi i Luleve

Thirrje për aplikim

QËLLIMI

Tregu i Luleve, aktivitet i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës ka për synim mbështetjen e bizneseve që merren me prodhimtarinë e luleve. Këto të fundit do të kenë rastin të bëjnë shitjen e produkteve të tyre në 6 shtëpiza të projektuara për shitjen e luleve.

RREGULLAT E TREGUT TË LULEVE

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e Tregut të Luleve do të bëhet (pas përzgjedhjes së aplikuesve) në sheshin "Skenderbeu". Gjatë këtyre muajve bizneset e përzgjedhura për shfrytëzimin e shtëpizave lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 23:00. Asnjë shitje nuk do të lejohet para orës 09:00 si dhe pas orës 23:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Tregun e Luleve do të bëhet nga një komision i posaçëm i formuar nga Kryetari i Komunës së Prishtinës. Pasi që numri i shtëpizave do të jetë i limituar është bërë aplikimi i kriterëve si më poshtë në mënyrë që selektimi të jetë sa më adekuat:

- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe të jenë pajisur me arkë fiskale;
- Bizneset duhet të kenë dëshmi të ushtrimit të veprimtarisë specifike për të cilën do të aplikojnë;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrorjnë në Tregun e Luleve;
- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut të luleve janë përcaktuar duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, (Rreg. nr. 011102782/2011) ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, bizneset e selektuara do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej **10 Euro për m² / në muaj** për periudhën e shrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Distribrimi i shtëpizave

Numri total i shtëpizave shfrytëzuese do të jetë 6 sosh ku secila do të jetë e dalluar me numrin që i takon. Distribrimi do të bëhet pasi që të përfundojë procesi i selektimit të bizneseve pjesëmarrëse.

Në rast të plotësimit të kriterëve nga një numër më i madh i aplikuesve se numri i shtëpizave do të aplikohet parimi i rrotacionit në bazë javore.

5) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mirë, Komuna e Prishtinës ndalon rreptësisht aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme mbrenda zonave të zhvillimit të tregut;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurrese, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave;
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpiën e tyre dhe hapësirën rreth saj.

Nëse bëhet kryerja e akteve të tilla, sanksionimi do të jetë marrja e lejës për shtëpiza si dhe në asnjë mënyrë nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzim të saj.

Aplikacionet mund të dorëzohen prej 15 maj deri më 24 maj 2017, në zyrën pritëse, sporteli nr.1 në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër).